



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 22.08.2023

Nr: 179

Ora: 13:00

**VENDIM**

**PËR MOSPRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 93, DATË 20.08.2023 TË DEPOZITUAR NGA "PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPËRISË"**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 22.08.2023, me pjesëmarrjen e:

Elvin	LAKO	-	Relator
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

**KËRKUES:** "Partia Demokratike e Shqipërisë", përfaqësuar nga Av. Rezart Kthupi dhe Av. Indrit Sefa;

**PERSON I INTERESUAR:** "Partia e Lirisë", përfaqësuar nga Av. Altin Kaziaj

**OBJEKTI:** 1. Ndryshimin e vendimit nr. 722 të datës 19.08.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve "Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarët dhe sekretarin e komisionit të zonës së

administrimit zgjedhor nr. 11, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023”

**BAZË LIGJORE:** Nenet 21 pika 1 shkronja “b”, 123/1, 124, 126, 129 dhe 130 të K.Zgjedhor

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur, konstatoi

### **Rrethanat e çështjes:**

1. Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 186, datë 11.08.2023, ka caktuar datën 24 shtator 2023, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve të pjesshme për kryetar të bashkisë Kukës.
2. Në zbatim të këtij dekreti dhe të neneve 19 pika 1 shkronja “n” dhe 29 pikat 1 dhe 4 të K.Zgjedhor, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka marrë vendimin nr. 722, datë 19.08.2023 “Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarët dhe sekretarin e komisionit të zonës së administrimit zgjedhor nr. 11, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023”.
3. Kundër këtij vendimi, partia politike “Partia Demokratike e Shqipërisë” (subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023) ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 93 regj., datë 20.08.2023. Në këtë kërkesë ankimore, kërkuesi kundërshton vendimin nr. 722, datë 19.08.2023 të KSHZ, duke kërkuar ndryshimin e vendimit. Më tej, në seancën për verifikimin paraprak, përfaqësuesit e ankimuesit parashtruan verbalisht edhe kërkimin se ndryshimi i vendimit objekt ankimi duhet të njihet Partinë Demokratike të Shqipërisë si partinë kryesore të opozitës parlamentare, bazuar në numrin e votave të fituara në shkallë vendi për këshillat vendorë në zgjedhjet pararendëse (14 maj 2023) nga partitë parlamentare, pavarësisht faktit se Partia Demokratike e Shqipërisë ka marrë 103,723 vota në shkallë vendi për këshillat vendorë dhe koalicioni “Bashkë Fitojmë” i udhëhequr nga Partia e Lirisë ka marrë 247,883 vota.

4. Përfaqësuesit e subjektit ankues, Partia Demokratike e Shqipërisë, parashtruan se subjekti zgjedhor koalicioni “Bashkë Fitojmë”, gjatë procesit të regjistrimit të listave të kandidatëve për këshillat vendorë në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, i ka depozituar ato në kundërshtim me fjalinë e fundit të nenit 67, pika 4 të K.Zgjedhor që parashikon se *“Për koalicionet përbri emrit të kandidatit shënohet cilës parti i përket kandidati”*, e për rrjedhojë edhe miratimi i këtyre listave nga KSHZ dhe KZAZ-të respektive është bërë në kundërshtim me ligjin. Po sipas përfaqësuesve të subjektit ankues, kjo paligjshmëri e zgjedhjeve pararendëse ka sjellë si pasojë pamundësinë e përlogaritjes së numri të votave për këshillat vendorë për partitë politike, pjesë përbërëse të subjektit zgjedhor koalicioni “Bashkë Fitojmë”, paligjshmëri që sipas tyre mund të zgjidhet me kërkesën ankimore objekt i këtij verifikimi paraprak nga KAS.
5. KAS-i caktoi me short anëtarin z. Elvin Lako si relator dhe vendosi zhvillimin e seancës paraprake në datën 22.08.2023, ora 13:00. Në seancë ishin të pranishëm administrata e KQZ-së, përfaqësuar nga zj. Madalena Koja, Drejtoresha e Ligjshmërisë, pala ankimuese, përfaqësuar nga Av. Rezart Kthupi dhe Av. Indrit Sefa dhe personi i interesuar Partia e Lirisë, përfaqësuar nga Av. Altin Kaziaj. Në lidhje me përfaqësimin e Partisë Demokratike të Shqipërisë nga personat e sipërcituar u prapësuan pretendime nga përfaqësuesi i palës së interesuar. Sipas këtij të fundit tagrat e përfaqësimit të Partisë Demokratike të Shqipërisë për të autorizuarin Indrit Sefa nuk ishin më në fuqi e për rrjedhojë as autorizimi i këtij të fundit nuk ishte në fuqi për nënshkruesin e ankimit, z. Rezart Kthupi. Përfaqësuesi i palës së interesuar i bazoi këto pretendime në faktin që autorizimet e z. Lulzim Basha (i lëshuar përpara se ai të dorëhiqej nga pozicioni i kryetarit të PD-së) dhe z. Enkelejd Alibeaj (i lëshuar pas njohjes së tij nga KAS si kryetar i komanduar i PD) nuk kanë më fuqi juridike për aq kohë sa të dy këto persona tashmë janë dorëhequr nga pozicionet që përfaqësojnë Partinë Demokratike të Shqipërisë me të tretët. Pavarësisht këtyre pretendimeve, KAS e legjitimoi z. Indrit Sefa për përfaqësimin e Partisë Demokratike të Shqipërisë duke qenë në cilësinë e përfaqësuesit të kësaj partie politike në KQZ në kuptim të nenit 26 të K.Zgjedhor dhe duke qenë se kjo parti politike është parti parlamentare, ai vijon ta gëzojë këtë status edhe jashtë periudhës zgjedhore për të cilën është caktuar si përfaqësues pranë KQZ-së.

### KAS-i konstaton:

1. Në zbatim të nenit 129, pika 3 të K.Zgjedhor, KAS:

*“... bën verifikimin paraprak të kërkesës ankimore dhe vendos:*

*a) kalimin e kërkesës për shqyrtim;*

*b) mospranimin e kërkesës për shkak të mungesës së elementeve të përcaktuara në nenin 130 të këtij Kodi; ose*

*c) kthimin e kërkesës për plotësim të elementeve të formës, të përcaktuara në nenin 126 të këtij Kodi”.*

2. Në lidhje me objektin e verifikimit paraprak, KAS i referohet nenit 130 të K.Zgjedhor që parashikon se:

*“KQZ-ja merr vendim për pranimin ose mospranimin e kërkesës ankimore, pasi verifikon elementet e mëposhtme:*

*a) kompetencën e KQZ-së për shqyrtimin e ankimit;*

*b) legjitimitimin e ankuesit; dhe*

*c) respektimin e afateve ligjore për ankimin”.*

Në interpretim të kësaj dispozite del qartë që të tre këto elemente duhet të plotësohen në mënyrë kumulative që kërkesa ankimore të konsiderohet e pranueshme për t’u shqyrtuar në themel të saj.

3. Në lidhje me kompetencën e KQZ/KAS për shqyrtimin e kësaj kërkesë ankimore, i referohemi nenit 124, pika 1 të K.Zgjedhor që parashikon se **“1. Çdo parti politike, pjesëtare ose jo e një koalicioni, dhe kandidati i propozuar nga zgjedhësit kanë të drejtë të ankohen në KQZ kundër vendimeve të KZAZ-së, që cenojnë interesat e tyre të ligjshëm, brenda 3 ditëve nga data e shpalljes së vendimit”** dhe nenit 21, pika 1, shkronja “b” e po këtij kodi që parashikon se **“1. Në përputhje me dispozitat e këtij ligji, KAS-i ushtron këto kompetenca: ... b) shqyrton dhe zgjidh në rrugë administrative ankesat ndaj akteve të Komisionerit”** çka e bën të qartë kompetencën e KAS për shqyrtimin e kësaj kërkesë ankimore.

4. Në lidhje me legjitimitetin e ankuesit që kërkohet nga neni 130, shkronja “b” e K.Zgjedhor, argumentojmë se drejta e një subjekti për të paraqitur kërkesë ankimore, lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me identifikimin e interesit të ligjshëm që ankimuesi ka ndaj vendimit objekt ankimimi. Subjektet kanë detyrimin të provojnë interesin e ligjshëm të tyre, duke provuar lidhjen e drejtpërdrejtë midis të drejtës apo interesit të pretenduar si të cënuar dhe vendimit që kundërshtohet si i paligjshëm.
5. Kodi Zgjedhor në nenin 130, shkronja “b” të tij parashikon se KAS merr vendim për pranimin ose mospranimin e kërkesës ankimore, pasi verifikon (...) legjitimitetin e ankuesit. E drejta e paraqitjes së ankimit lidhet me vërtetimin e ekzistencës së një interesi të ligjshëm të palës ankuese e cila ngre një pretendim, dhe që kërkon të dëgjohet mbi themelin e këtij pretendimi.
6. Si fillim, për të arsyetuar nëse ankimuesi ka interes të ligjshëm në ngritjen e pretendimit objekt ankimi, duhet arsyetuar gjeneza e pretendimit, që ka të bëjë pikërisht me momentin e regjistrimit të listave të kandidatëve për këshillat vendorë pranë KQZ/KZAZ për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023 për subjektin zgjedhor koalicionin “Bashkë Fitojmë”, subjekt zgjedhor i ndryshëm nga Partia Demokratike e Shqipërisë dhe ku kjo e fundit nuk ishte pjesë e atij koalicioni. Këtu vlen për t’u theksuar se çdo subjekt zgjedhor e kryen këtë veprim (depozitimin e listave të kandidatëve për këshillat vendorë) me vullnetin e tij dhe pa patur dijeni paraprake për listat e kandidatëve të subjekteve të tjera zgjedhore, si në rastin e partive politike ashtu edhe të koalicioneve. Në këtë rast çdo subjekt do të kishte interes të ligjshëm të paraqiste ankim, kundrejt vendimit të KQZ/KZAZ, për regjistrimin ose jo të listave të vetë subjektit dhe jo të subjekteve të tjera.
7. Tashmë praktika zgjedhore si ajo administrative (KAS), por po ashtu edhe ajo gjyqësore (Kolegji Zgjedhor Gjyqësor) kanë krijuar standard sa i përket koalicioneve dhe legjitimitetit në lidhje me veprimet/mosveprimet e tyre kur pretendohen nga parti politike jo pjesë e këtyre koalicioneve. Më konkretisht, me vendimin Nr. 8 Regj. Them., datë 19.04.2021, Kolegji Zgjedhor, ndër të tjera, ka arsyetuar se:

*“... duhen dalluar dy situata qartësisht të ndryshme me njëra-tjetrën të cilat kanë si parakusht formën e garimit në zgjedhje të një partie politike siç është dhe PDIU. Nëse kjo*

parti politike do të paraqitej e vetme në zgjedhje, duke paraqitur listën e vetë të kandidatëve, atëherë ajo do të gëzonte të plota të gjitha të drejtat që i njej Kodi Zgjedhor, përfshirë dhe ato sipas neneve 95, 96 e 183(8) të këtij Kodi. PDIU në këtë rast do të paraqitej si subjekt zgjedhor më vete, në kuptim të nenit 63(1) të Kodit Zgjedhor. Kjo dispozitë referuar personave juridikë që veprojnë si parti politike njej si subjekte zgjedhore vetëm dy kategori: 1) partinë politike që garon e vetme dhe paraqet po e vetme listë kandidatësh për konkurrim në zgjedhje dhe 2) koalicionin e disa partive politike, i cili paraqet listë kandidatësh për garim në zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë. Varësisht formës së futjes në garë të një partie politike (e vetme apo në koalicion), rrjedhin edhe disa kufizime të të drejtave të veta sipas Kodit Zgjedhor, të cilat lidhen me cilësinë si subjekt zgjedhor të partisë politike.

21. Në rastin konkret, neni 65(3) i Kodit Zgjedhor ka përcaktuar shprehimisht se “Për nevojat e zbatimit të këtij ligji, të gjitha të drejtat dhe detyrimet që ky ligj përcakton për subjektet zgjedhore përmbushen nga partia udhëheqëse e koalicionit”. Përrjashtim nga ky rregull bëhet vetëm nëse ligji e parashikon shprehimisht një gjë të tillë, sipas natyrës së të drejtës që diskutohet. Ky formulim është shtuar me ligjin nr. 118/2020, datë 5.10.2020 dhe për rrjedhojë si rregullim i miratuar më vonë në kohë, kushtëzon dhe përcakton kuptimin e dispozitave të tjera të Kodit Zgjedhor, të cilat krijojnë përplasje me të. **Duke qenë se në rastin konkret, subjekt zgjedhor garues është koalicioni PD-AN, këtij i përkasin të gjitha të drejtat dhe detyrimet që Kodi parashikon për subjektet zgjedhore, në lidhje me administrimin e zgjedhjeve të 25 prillit 2021. Ky koalicion përfaqësohet nga Partia Demokratike dhe me të drejtë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka vlerësuar se meqë PD ishte tashme e përfshirë në përcaktimin e kryetarit apo nënkryetarit të KZAZ-ve, në zbatim të nenit 96 të Kodit Zgjedhor, e drejta e propozimit të anëtarit të katërt, duhet t’i kalonte LSI-së. LSI duke mos qenë në koalicion me Partinë Demokratike, në dallim nga PDIU, ka ruajtur për vete të gjitha të drejtat që i njej Kodi Zgjedhor, në lidhje me fazën e kontributit të subjekteve zgjedhore në administrimin e zgjedhjeve. PDIU në këtë rast, përse i përket të drejtës për propozim të anëtarit të katërt, apo për efekt të përfshirjes në short bashkë me LSI, duke qenë se është përfshirë në koalicionin PD-AN, vlerësohet se barazohet me pozitën e PD (kjo e fundit përmbush të gjitha të drejtat që rrjedhin nga Kodi Zgjedhor për subjektin garues në zgjedhje) e cila tashmë e ka të drejtën për propozimin e një anëtarit të GNV. Kjo do të thotë se e drejta spostohet te LSI dhe vetëm nëse kjo e fundit (si subjekt i vetëm që mbetet e**

që plotëson kriteret ligjore sipas nenit 96(1) të Kodit Zgjedhor) zgjedh të mos propozojë anëtarin e katërt të GNV, atëherë në zbatim të nenit 96 (1/1) të Kodit Zgjedhor, e drejta i rikthehet PD, e cila vepron si përfaqësuese e koalicionit PD-AN. Në këtë rast hipotetik, PD-ja mund të zgjidhte në marrëveshje me PDIU, që të caktonte konkretisht përfaqësues të kësaj të fundit në të gjitha apo një pjesë të GNV-ve.

22. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vëren se neni 96 i Kodit Zgjedhor ka mbetur i pandryshuar që nga vitit 2012 dhe rregullat e përcaktuara në të, duhet të shihen në dritën e ndryshimeve substanciale që solli ligji nr. 118/2020, datë 5.10.2020, veçanërisht në lidhje me kuptimin e të drejtave të subjekteve garuese në zgjedhje, sipas nenit 65(3) të Kodit Zgjedhor. PDIU nuk mund të veprojë sikur nuk është pjesë e PD-AN, pasi ajo me vullnetin e saj të lirë është bërë pjesë e një koalicioni garues në zgjedhjet e 25 prillit 2021. Duke u futur në këtë koalicion PDIU ka pranuar të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin jo vetëm nga marrëveshja e nënshkruar nga të gjitha partitë, por dhe nga efektet që rrjedhin nga zbatimi i arsyeshem i dispozitave të caktuara të Kodit Zgjedhor. ... për efekt të zbatimit të nenit 96 të Kodit Zgjedhor (në vështrim të nenit 65(3) të këtij kodi), **pozita e PDIU shkrihet me atë të PD, e cila është partia udhëheqëse e koalicionit PD-AN, i cili gëzon cilësinë e subjektit garues në zgjedhjet e 25 prillit 2021**".

8. Për t'u rikthyer te çështja objekt shqyrtimi, në interpretim *a contrario* të përfundimeve të arritura nga Kolegji Zgjedhor në çështjen e mësipërme, duke qenë se Partia e Lirisë ka garuar si pjesë e një koalicioni (Bashkë Fitojmë) në zgjedhjet e 14 majit 2023, së bashku me Partinë Demokristiane dhe Partinë e Bashkimit për të Drejtat e Njeriut, por që **parti udhëheqëse e koalicionit, në kuptim të nenit 65, pika 3 të K.Zgjedhor, ka qenë Partia e Lirisë, atëherë kjo e fundit barazohet me koalicionin në raport me palët e treta, subjektet e tjera zgjedhore ku përfshihet dhe ankimuesi Partia Demokratike e Shqipërisë.**

9. Në lidhje me përbërjen e KZAZ-së, neni 29 i K.Zgjedhor ndër të tjera parashikon se:

"1. KZAZ-ja përbëhet nga 7 anëtarë dhe sekretari, të cilët emërohen nga KQZ-ja, sipas procedurës së mëposhtme:

a) dy anëtarë propozohen nga partia kryesore e shumicës parlamentare, **dy anëtarë propozohen nga partia kryesore e opozitës parlamentare, një anëtar propozohet nga partia e**

*dytë e shumicës parlamentare dhe një anëtar propozohet nga partia e dytë e opozitës parlamentare. Në rast se nuk arrihet baraspeshimi politik, sipas kësaj shkronje, grupi përkatës kompensohet me kandidaturat e partisë kryesore deri në baraspeshimin politik shumicë-opozitë;*

...

*4. Renditja e partive për efekt të ndarjes së vendeve në KZAZ, sipas përcaktimeve të këtij neni, bëhet mbi bazën e numrit të mandateve që ka fituar partia politike nga zgjedhjet pararendëse për Kuvendin. **Në rastin e zgjedhjeve vendore, renditja përcaktohet mbi bazën e numrit të votave të fituara në shkallë vendi për këshillat vendorë në zgjedhjet pararendëse nga partitë parlamentare**".*

10. Argumenti në të cilin ankimesi bazon pretendimin e tij në lidhje me përcaktimin e partisë kryesore të opozitës parlamentare, është ai i ndarjes (ose më saktë i pamundësisë për të përcaktuar numrin e votave për secilën parti politike përbërëse të koalicionit) së votave mes partive të subjektit zgjedhor koalicioni "Bashkë Fitojmë" në zgjedhjet e datës 14 maj 2023. Sipas ankimesit, mosrespektimi nga ana e këtij koalicioni i rregullit që "Për koalicionet përbri emrit të kandidatit shënohet cilës parti i përket kandidati", ka cënuar interesin e ligjshëm të Partisë Demokratike të Shqipërisë në favor të Partisë së Lirisë. Pretendimi i ankimesit lidhet me marrëveshjen që partitë politike përbërëse të koalicionit "Bashkë Fitojmë" kanë dakordësuar për zgjedhjet e datës 14 maj 2023. Pretendime të ngjashme pala ankimese ka ngritur edhe gjatë periudhës zgjedhore që i korrespondonte zgjedhjeve të datës 14 maj 2023, pretendime për të cilat nuk është legjitimuar për mungesë të interesit të ligjshëm. Kanë qenë vendimet nr. 32, datë 23.03.2023 të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve dhe nr. 6, datë 30.03.2023 të Kolegjit Zgjedhor që kanë konfirmuar këtë qëndrim. Më konkretisht, Kolegji Zgjedhor ka arsyetuar se:

*"13. Me të drejtë KAS nuk e ka legjitimuar në procesin administrativ të zhvilluar para tij palën paditëse në këtë gjykim, dhe ka marrë vendimin Nr. 32, datë 23.03.2023, për mospranimin për shqyrtimin të kërkesës ankimore të palës paditëse.*

***Pala paditëse i ka realizuar interesat e saj të ligjshme në procesin administrativ të zhvilluar para Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, ku është marrë vendimi nr.178, datë 18.03.2023***



***dhe nuk mbronte asnjë interes të ligjshëm kur kundërshtonte me ankim në KAS vendimin nr.178, datë 18.03.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.***

*14. Për të njëjtat arsye të parashtruara në vendimin Nr. 32, datë 23.03.2023 të KAS, Kolegji Zgjedhor vlerëson se, pala paditëse nuk mbron interesa ligjore para Kolegjit Zgjedhor kur kundërshton me padi vendimin nr.178, datë 18.03.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe vendimin Nr. 32, datë 23.03.2023 të KAS, për sa kohë me këto vendime nuk janë cenuar interesat e ligjshme të palës paditëse, në kuptim të nenit 145/1 të K.Zgjedhor”.*

11. Referuar sa më sipër, për KAS bëhet e qartë që për aq kohë sa për subjektet zgjedhore koalicion, të drejtat dhe detyrimet në lidhje me administrimin zgjedhor merren përsipër nga partia udhëheqëse e koalicionit, atëherë çdo pretendim për përkatësinë e votave mes partive përbërëse të koalicionit, mund të ngrihet vetëm nga parti politike pjesëtare në koalicion dhe jo nga palë të treta, si në rastin objekt shqyrtimi. Janë pikërisht partitë politike pjesëtare të koalicionit që mund të ngenë pretendime të tilla dhe që mund të kenë interes të ligjshëm në kuptim të nenit 88 pika 3 të K.Zgjedhor që rregullon financimin e partive pjesëmarrëse në zgjedhje.

**12. Po ashtu, vlen të theksohet se për zgjedhjet e organeve vendore, ndryshe nga ato për Kuvendin e Shqipërisë, e drejta për propozimin e anëtarëve të KZAZ-së lidhet me numrin e votave dhe jo të mandateve në këshillat vendorë. Edhe nëse do ishte e qartë se sa mandate këshilltaresh ka fituar secila parti politike pjesëtare e një koalicioni, nuk do kishte asnjë vlerë për mosmarrëveshjen objekt shqyrtimi, për aq kohë sa referenca e ligjit në rastin e zgjedhjeve të organeve vendore janë votat dhe jo mandatet e fituara.**

13. Përfundimisht, në vlerësimin e KAS, bazuar në vetë pretendimet e ankimesit, këtij të fundit nuk i është shkelur ndonjë e drejtë dhe as i është cënuar interesi i ligjshëm i pretenduar. Për pasojë ai nuk legjitimohet në kundërshtimin e vendimit nr. 722 të datës 19.08.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarët dhe sekretarin e komisionit të zonës së administrimit zgjedhor nr. 11, për zgjedhjet e pjeshme për kryetar të bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023”. Në lidhje me interesin e ligjshëm të palës ankimese në kërkimin e saj, i cili vlerësohet rast pas rasti, i referohemi

*mutatis mutandis* edhe vendimit unifikues nr. 5, datë 30.10.2012 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë që ndër të tjera kanë arsyetuar se:

*“... Pra, interesi për të ngritur padi lind nga domosdoshmëria për të mbrojtur interesin material dhe për këtë arsye, në esencë, presupozon njohjen e cenimit të një interesi që mund të përmbushet duke kërkuar mbrojtjen në gjykatë. **Në këtë vështrim juridik nuk mund të merret në shqyrtim një padi kur në situatën faktike, aktuale, nuk njihet apo nuk evidentohet cenimi i një të drejte ose i një interesi që mund të pretendohet kundrejt palës tjetër.***

*28.1. Interesi për të ngritur padi rezulton nga marrëdhënia midis situatës së kundra ligjshme që pretendohet dhe vendimit gjyqësor që kërkohet të merret për të rregulluar këtë situatë nëpërmjet zbatimit të së drejtës në fuqi, marrëdhënie që domosdoshmërisht duhet të konsistojë në dobishmërinë e vendimit që kërkohet të merret.*

*29. Mungesa e një interesi do të thotë se, nëse ushtrimi i padisë nuk i siguron paditësit asnjë avantazh, gjykata duhet ta deklarojë atë si të papranueshme.*

*30. Dhe po kështu, nëse mungon apo paditësi nuk arrin të provojë faktin cenes të së drejtës së tij padia është e papranueshme”.*

**Për rrjedhojë, në situatën faktike, aktuale, për aq kohë sa nuk evidentohet cënimi i një të drejte ose i një interesi i palës ankimuese, ajo nuk legjitimohet në kërkimin e saj. Interesi i ligjshëm nuk mund të justifikohet vetëm me faktin se ka qenë Partia Demokratike e Shqipërisë ajo që historikisht ka gëzuar statusin e partisë kryesore të opozitës parlamentare, pasi interesi i ligjshëm është koncept ligjor dhe si i tillë analizohet rast pas rasti duke ju referuar aktualitetit të mosmarrëveshjes ligjore dhe jo historikut të një statusi.**

14. Në lidhje me elementin e tretë të parashikuar nga neni 130 shkronja “c” të K.Zgjedhor, atë të respektimit të afateve ligjore për ankimin, i referohemi nenit 124/1 pika 2 të K.Zgjedhor që parashikon se “2. *Kundër akteve të Komisionerit lejohet ankim në rrugë administrative në KAS nga palët që demonstrojnë një interes të ligjshëm për çështjen objekt i ankimit. Në periudhën nga dalja e dekretit të Presidentit të Republikës për zhvillimin e zgjedhjeve deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar, ankimi paraqitet brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit. Për periudhën*

tjetër, ankimi paraqitet brenda 30 ditëve nga dalja e vendimit.”. Vendimi i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve objekt ankimi është i datës 19.08.2023, ora 12:00, ndërkohë kërkesa ankimore është depozituar në KQZ në datë 20.08.2023, ora 11:20. Në lidhje me përlogaritjen e afateve, do i referohemi nenit 125 të K.Zgjedhor që parashikon se:

*“1. Afatet që në Pjesët X dhe XI të këtij Kodi janë përcaktuar me orë llogariten duke përfshirur orën në të cilën lind e drejta e ankimit ose detyrimi administrativ. Në të gjitha rastet kur afatet në këtë Kod llogariten me orë, organi administrativ i ngarkuar nga ky Kod është i detyruar të shënojë në aktin administrativ orën e shpalljes së aktit. Në rast të kundërt, afati llogaritet duke filluar nga ora 8:00 e ditës pasardhëse.*

**2. Afatet që në këtë pjesë janë përcaktuar me ditë llogariten duke përfshirur ditën në të cilën lind e drejta e ankimit ose detyrimi administrativ.**

*3. Në rast se plotësimi i afateve, sipas pikës 2 të këtij neni, bie jashtë orarit zyrtar të punës, të përcaktuar në vendimin e KQZ-së, atëherë ecja e afatit pezullohet në orën e mbarimit të orarit zyrtar dhe rifillon në orën e fillimit të orarit zyrtar në ditën pasardhëse.*

*4. Në rast se plotësimi i afateve bie në ditët e pushimeve ose festave zyrtare, afati fillon në ditën më të parë pasardhëse të punës.*

*5. Për afatet e ankimit, sipas kësaj pjese, nuk mund të ketë rivendosje në afat.*

*6. Për efekt të këtij neni, në rast se nga KQZ-ja nuk është përcaktuar ndryshe me vendim, orar zyrtar i punës llogaritet koha nga ora 8:00 deri në orën 16:00 dhe ditë pushimi janë dita e shtunë dhe dita e diel”.*

Referuar sa më sipër, formalisht është respektuar afati për ankimin ndaj vendimit nr. 722 të datës 19.08.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarët dhe sekretarin e komisionit të zonës së administrimit zgjedhor nr. 11, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023”.

**15.** Megjithatë, në lidhje me elementin e respektimit të afateve ligjore për ankimin, KAS nuk mund të anashkalojë faktin që argumentet e paditësit në lidhje me këtë ankim, bazohen vetëm në pretendimin se kundërligjshmëria rrjedh nga vendimi nr. 261, datë 4.4.2023 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për shqyrtimin e kërkesës për miratimin e disa listave shumëmemërore, për koalicionin “Bashkë Fitojme”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14

maj 2023” dhe vendimeve respektive me këtë objekt të marra nga KZAZ-të përkatëse<sup>1</sup>. Sipas ankimesit këto vendime janë marrë në kundërshtim me K.Zgjedhor, më konkretisht me fjalinë e fundit të nenit 67, pika 4 e tij. Është pikërisht kjo baza me të cilën ngrihet pretendimi në këtë çështje, çka për KAS është në tejkalim të afateve të përcaktuara nga K.Zgjedhor të cituara më sipër. Ankimesi e ka pasur të gjithë mundësinë që me të njëjtat argumente t’i kundërshtonte këto vendimmarrje gjatë periudhës zgjedhore për zgjedhjet e datës 14 maj 2023. **Ngritja tashmë e pretendimeve në lidhje me këto vendimmarrje do të cënonte parimin e sigurisë juridike, ndaj për KAS, pavarësisht se në objektin e ankimit kërkohet vetëm ndryshimi i vendimit nr. 722 të datës 19.08.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, për aq kohë sa ky ankim bazohet në pretendime për kundërligjshmëri të vendimeve për të cilat ka kaluar afati i ankimit, vendime këto pazgjidhshmërisht të lidhura me objektin e këtij ankimi, atëherë nuk plotësohet as elementi i respektimit të afatit ligjor të ankimit.**

16. Ndodhur në këto kushte, KAS vlerëson të theksojë për palët se ndonëse ligjvënësi e ka liberalizuar të drejtën e ankimit për çështjet zgjedhore (duke mos përcaktuar tarifë, apo penalitet për kërkime abuzive), subjektet zgjedhore nuk mund të investojnë organet/procesin ankimor për çdo kërkesë apo pretendim duke shtyrë në limite kohore afatet dhe testuar kapacitetet administrative të organeve zgjedhore, aq më tepër duke pasur parasysh natyrën administrative *sui generis* të procesit zgjedhor dhe afatet e “ngushta” të tij.
17. Për sa argumentuam më sipër, duke qenë se nuk plotësohen elementet e legjitimitetit të ankimesit dhe të respektimit të afateve ligjore për ankimin e për rrjedhojë nuk përmbushen në mënyrë kumulative të tre kushtet e parashikuara në nenin 130 të K.Zgjedhor,

---

<sup>1</sup> Neni 67 pika 1 paragrafi i dytë dhe pika 2 e K.Zgjedhor – “Për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, kandidati për kryetar të njësisë së qeverisjes vendore dhe lista e kandidatëve për këshillat vendore regjistrohen në KZAZ-në që mbulon njësinë e qeverisjes vendore brenda afatit të përcaktuar në këtë pikë. KZAZ-ja dorëzon një kopje të listës në KQZ brenda 48 orëve.

2. Në zbatim të paragrafit të dytë të pikës 1 të këtij neni, lista e subjektit depozitohet në KQZ në rastet kur territori i njësisë së qeverisjes vendore nuk mbulohet nga një KZAZ e vetme”.

## PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “b” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i, me shumicë votash

## V E N D O S I:

1. Mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 93, datë 20.08.2023, të paraqitur nga “Partia Demokratike e Shqipërisë”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Bazuar në pikën 1 të nenit 145 të Kodit Zgjedhor, kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij, sipas përcaktimit të pikës 2 të nenit 152 të Kodit Zgjedhor.

U shpall sot më 22.08.2023.

<b>Elvin</b>	<b>LAKO</b>	-	<b>Relator</b>	<b>(Kundër)</b>
<b>Elvis</b>	<b>ÇEFA</b>	-	<b>Anëtar</b>	
<b>Ilirjan</b>	<b>RUSMALI</b>	-	<b>Anëtar</b>	<b>(Kundër)</b>
<b>Koli</b>	<b>BELE</b>	-	<b>Anëtar</b>	
<b>Ledio</b>	<b>BRAHO</b>	-	<b>Anëtar</b>	